



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Pritmjen/Prodato Received/Delivery	16 11 2023	3 viti god year	
Organ /Njesia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSHCK	6996/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1227/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1227/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesja nga Obiliqi, kundër Vendimit me numër reference Nr.ref.522/2023 të datës 01.09.2023 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike „Transferim“, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1227/2023 e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër reference Nr.ref.522/2023 i datës 01.09.2023 të Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën “Zyrtare e lartë për komunikim me publikun” në Divizionin për Komunikim Publik, sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.94/2022 të datës 13.06.2022, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.94/2022 të datës 13.06.2022 në pozitën e punës „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun” në Divizionin për Komunikim me Publikun në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Më datë 01.09.2023 përmes e-mailit zyrtar është njoftuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore se do të transferohet përkohësisht në pozitën „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore” në Divizionin për Shërbime Konsullore/Departamenti për Çështje Konsullore.

Më datë 01.09.2023 Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ka nxjerrë Vendimin me numër reference Nr.ref.522/2023, përmes të cilit ankuesen e ka transferuar përkohësisht nga pozita „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun” në „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore” në Divizionin për Shërbime Konsullore/Departamenti për Çështje Konsullore nga data 01.09.2023 deri më 29.02.2024.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër reference Nr.ref.522/2023 të datës 01.09.2023 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6302/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak se Vendimi i lartë cekur përmbanë: vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike; shkeljeve ligjore dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli, me datën 10.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesën e ankueses së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 6302/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me numër AE.Nr.94/2022 të datës 13.06.2022; Vendimin me numër reference nr.ref.522/2023 të datës 01.09.2023 të nxjerrë nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore-MPJD; E-mail i datës 01.09.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore-MPJD për Q.F; Konkurs me numër reference Nr.MPJ-DSHK-001/13; Konkurs me numër reference Nr. RN00011393 i datës 27.04.2023; E-mail i datës 03.04.2023 nga Akademia Diplomatike për B.I,B.I dhe F.S; E-mail i datës 04.09.2023 për F.S; E-mail i datës 11.09.2023 për F.S; Ligji me numër Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligji me numër nr.05/L-093 për Ratifikimin e Konventës për Heqjen e Kërkesës për legalizim të Dokumenteve Zyrtare të Huaja; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 05.10.2023; Përgjigje në ankesë nga MPJD e datës 10.10.2023; E-mail i datës 01.09.2023 nga a.M për Q.F; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 17.04.2023; Akt Emërimi me numër protokolli 1693 i datës 30.09.2023; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 24.07.2023; E-mailat e datës 04.09.2023; E-mail i datës 29.09.2023; E-mail i datës 28.09.2023; Provë shtesë E-maili i datës 25.10.2023; Diplomën me numër Nr.38888 të datës 06.09.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë/Dega Gazetari.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën me numër protokolli 6302/2023 të datës 02.10.2023, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër reference Nr.ref.522/2023 i datës 01.09.2023 i Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës përmes së cilit e njëjta është transferuar përkohësisht nga pozita „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun“ në pozitën „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore“ është jo i plotë dhe jo i drejtë për shkak se nuk është paraqitur kërkesa për transferim dhe nuk është në dijeni se me çfarë procesi është bërë përzgjedhja e saj për transferim, gjithashtu pretendon se detyrat dhe përgjegjësit e Divizionit për Komunikim me Publikun dhe Divizionit për Shërbime Konsullore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë krejtësisht të ndryshme gjithashtu pretendon se Vendimi me numër reference Nr.ref.522/2023 i datës 01.09.2023 i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse nuk përmban strukturën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të provave të lëndës si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se bazuar në formularin e përshkrimit të detyrave të punës del se pozita e punës „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun“ të cilën e mbanë ankuesja sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.94/2022 të datës 13.06.2022, në Divizionin për Komunikim me Publikun të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, tek fusha e përgaditjes profesionale të arsimit kërkohet „Diplomë Universitare në Gazetari, Shkenca Politike dhe Letërsi Shqipe“, ndërsa në pozitën e punës „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore“ në Divizionin për Shërbime Konsullore në kuadër të Departamentit për Çështje Konsullore, në të cilën ankuesja është transferuar përkohësisht nga data 01.09.2023 deri më 29.02.2024 dhe është caktuar ti kryej punët dhe detyrat nga kjo pozitë, bazuar në formularin e përshkrimit të detyrave të punës, tek fusha e përgaditjes profesionale të arsimit kërkohet „Njohuri e thellë dhe e spacializuar në fushën profesionale, specifikisht në lëmin Juridik, Administrat Publike, Shkencave Politike të fituara përmes arsimimit Universitar dhe trajnimeve përkatëse“.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se bazuar në provat e bashkangjitura të lëndës nga organi i punësimit, konkretisht Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ankuesja posedon Diplomë Universitare me numër Nr.3888 të lëshuar më datë 06.09.2017 nga Universiteti i Prishtinës, me të cilën dëshmohet se ankuesja më datën 07.11.2014 mbaroi studimet në Fakultetin e Filologjisë, Dega Gazetari dhe mori titullin „Bachelor i Gazetarisë“. Andaj mbi këtë bazë si dhe bazuar në dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë transferimin e nëpunësve civil gjegjësisht sipas nenit 4 paragrafi 1 i Rregullores (QRK) me numër Nr.14/2023 për Transferimin e Nëpunësve Civil sipas të cilës është përcaktuar se: „1.Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52. paragrafin 1 të Ligjit“. Ndërlidhur me këtë Kolegji i Këshillit vlerëson se pozita „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore“, në të cilën ankuesja është transferuar përkohësisht dhe është autorizuar për kryerjen e punëve dhe

detyrave pranë Divizionit për Shërbime Konsullore në Kuadër të Departamentit për Çështje Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e njëjta duhet të jetë me kualifikim „ në lëmin Juridik, Administratë Publike dhe Shkenca Politike“, e që rrjedhimisht edhe nëpunësi civil i cili ushtron pozitën „Zyrtar i Lartë për Shërbime Konsullore“ në bazë të përshkrimit të detyrave të punës duhet të posedoj Diplomë Universitare në lëmit e lartë cekura. Andaj bazuar në Rregulloren (QRK) me numër Nr.14/2023 për Transferimin e Nëpunësve Civil, pozita e punës „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun“ dhe „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun“ nuk janë në të njëjtën kategori, nga rrjedhë se edhe pretendimi i ankueses se detyrat dhe përgjegjësit e Divizionit për Komunikim me Publikun dhe Divizionit për Shërbime Konsullore në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë krejtësisht të ndryshme sipas vlerësimit të Kolegjit është i bazuar dhe ligjor.

Bazuar në këtë fakt, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se përgatitja profesionale e ankueses nuk është e përshtatshme me përgatitjen profesionale, që kërkohet për pozitën e punës „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore“ për të cilën e njëjta është transferuar përkohësisht sipas Vendimit me numër Nr.522/2023 të datës 01.09.2023, andaj në këtë kuptim Kolegji i Këshillit, vlerëson se për rastin konkret të ankueses nuk është bërë analizë e saktë nga njësia përgjegjëse lidhur me plotësimin e kushteve për transferimin e saj nga pozita „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun“ në „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore“, prandaj nga konstatimet si më lartë Kolegji i Këshillit vlerëson se Vendimi me numër Nr.522/2023 i datës 01.09.2023 i nxjerrë nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për transferim të përkohëshëm të ankueses në pozitën „Zyrtare e Lartë për Shërbime Konsullore“ nga data 01.09.2023 deri më 29.02.2024, është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe si i tillë është i kundërligjshëm.

Theksuar si më sipër, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë dhe duke u bazuar në autorizimet e përcaktuara me nenin 55 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me numër Nr.522/2023 të datës 01.09.2023 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthej ankuesen Qëndresa Fazliu në pozitën e punës „Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun“ në Divizionin për Komunikim me Publikun, sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.94/2022 të datës 13.06.2022, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.

Në rast të mos zbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se Vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1227/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetarja e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.